



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN**

Elbasan, më . . .2025

Procesverbal -Tipi i kontrates - Mall

(Për argumentimin e kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit)

OBJEKTI I PROÇEDURËS - “Blerje piano”.

LLOJI PROÇEDURËS - “Procedurë e hapur e thjeshtuar– Mallra”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Kodi CPV:
Piano 37311100-2

VLERA E FONDIT LIMIT - 3,333,333 (tremilion e treqind e tridhjetë e tremijë e treqind e tridhjetë e tre) **lekë pa t.v.sh**

Ne baze të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti kontraktor Bashkia Elbasan ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e kriterëve për kualifikim për procedurën e sipercituar, me përmbajtjen si mëposhte:

Shtojca 8.

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

OFERTUESI DEKLARON SE:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);

- c) nuk është dënua për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënua ose nuk ka qenë i dënua nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.
- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/Enti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet:

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

Kriteret e përgjithshme përmbajnë listën e dokumentacionit, ligjor dhe administrativ, të kandidatëve/ofertuesve, që duhet të plotësojnë për të marrë pjesë në procesin e prokurimit, në përputhje me nenin 76 dhe 77 të LPP-së, nr.162 date 23.12.2020 “Per prokurimin Publik”, i ndryshuar.

Kriteret e përgjithshme për pranimin e operatorëve pjesëmarrës janë të pandryshueshme dhe janë vënë të njëjta me Dokumentet Standarde të Tenderit sipas Vendimit Nr. 10 Datë 23.09.2024 te miratuara nga APP.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

Kriteret (a-b) janë vendosur në përputhje me Dokumentat e Tenderit të miratuara nga APP bazuar në Vendimit Nr. 10 Datë 23.09.2024 si dhe bazuar në Ligjin Nr.162/2020 “Per prokurimin publik”, i ndryshuar.

Pika a) bazohet në nenet 76, 77 dhe 82 të LPP si dhe nenit 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Pika b) është vendosur në bazë të nenit 30 pika 1 të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas Shtojcës 8;

2.1.1 Operatori ekonomik duhet të ketë paguar **taksat dhe tarifave vendore për vitin 2025 (këstet e maturuara)** për çdo vend të ushtrimit të aktivitetit (sipas QKB), sipas afateve të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore.

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë vërtetim për taksat dhe tarifave vendore).

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, i cili vërteton pagimin e taksave dhe tarifave vendore, do të dorëzohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentimi: Kriteri 2.2.2 është vendosur bazuar në nenin 76, pika 2 të LPP sidhe në ligjin Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar. Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar që operatorët ekonomikë nuk kanë pagesa të pashlyera të taksave dhe tarifave vendore.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.2.1 Kopje të deklaratave të xhiros vjetore të leshuara nga administrata tatimore për gjatë tre viteve të fundit, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jete **jo më e vogël se 40 % e fondit limit të prokuruar.**

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Për të provuar përvojën e mëparshme operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizime të ngjashme në një vlerë jo më të vogël se **20%** e vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Kjo do të vërtetohet me dokumentat e mëposhtme:

- a) **Ne rastin e përvijes se mëparshme te realizuar me sektorin publik**, operatori ekonomik duhet te paraqese vertetime te leshuara nga nje ent publik ose fatura tatimore te shitjes dhe te deklaruar ne organet tatimore, ku të jenë shënuar saktë datat, shumat, sasitë e mallrave të furnizuara,

ose

- b) **Në rast se përvija e mëparshme është realizuar me sektorin privat**, si deshmë do të pranohen vetëm fatura tatimore shitje, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar ne organet tatimore, ku të jenë shënuar saktë datat, shumat, sasitë e mallrave të furnizuara.

Kriteri 2.3.1 është vendosur referuar nenit 40 pika 4 dhe nenit 55, pika 4 germa b) të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” si dhe bazuar në nenin 77 pika 4 të LPP nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”. Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues ka përvijën e duhur për të përmbushur me sukses kontratën.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të disponojë dhe të paraqesë çertifikatën e vlefshme:

- **SSH/EN-ISO 9001-2015 “Sistemi i Menaxhimit të Cilësive” ose ekuivalente, e vlefshme, dhe të perputhet në mallin objekt prokurimi.**

Çertifikata e mesipërme duhet të jetë e leshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Qëllimi i certifikimit të kompanisë duhet të jetë sipas fushës së objektit që do të prokurohet.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë çertifikatën ISO sipas zërave të punëve/mallrave/shërbimeve që do të marr përsipër të realizojë sipas akt-marrëveshjes paraprake.

Argumentimi: Kërkesat e mesipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenin 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që si kompani kanë kualifikimet/çertifikimet e duhura organizative dhe operacionale të nevojshme për të zbatuar kontratën.

Në nenin 79, të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ndër të tjera parashikohet se: Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose

shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.

Në çdo rast, certifikatat e kërkuara duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit.

Në nenin 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ndër të tjera parashikohet se: Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.

Certifikimi ISO 9001 ose ekuivalent shërben për të verifikuar dhe garantuar që OE i interesuar është në gjendje të kryejë realizimin e kontratës në fjalë në mënyrë cilesore dhe të plotë, bazuar në organizimin e brendshëm për menaxhimin sa më të mirë të cilësive implementuese. Ky certifikim kërket në përputhje me proporcionalitetin e vlerës së fondit limit të venë në dispozicion dhe bazuar në kompleksitetin dhe rëndësinë e funksionalitetit të sistemeve që do të instalohen.

2.3.3 Në rast se operatori ekonomik ofertues nuk është prodhues, ai duhet të paraqesë kontratë furnizimi /autorizim nga prodhuesi ose distributor zyrtar për mallin objekt prokurimi. Në rastin e kontratës së furnizimit/autorizimit me distributorin të dokumentohet lidhja e tij me prodhuesin. Kontrata/autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme nga Autoriteti Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

Argumentimi: Në bazë të nenit 77 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe pika 6 b), pikën 8, të nenit 40, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës dëshmojnë origjinalitetin e mallrave të furnizuara, e rrjedhimisht mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin dokumentacion lidhur me origjinën e mallrave të lëshuara direkt nga prodhuesi apo nga distributori i autorizuar i tyre. Kështu autorizimi i prodhuesit apo distributorit të autorizuar, tregon nëse OE kanë mundësinë të ofrojnë mallra origjinale, në cilësi dhe me standarde ndërkombëtare, duke garantuar mbështetjen e kompanisë prodhuese/distributore gjatë procesit të furnizimit/vendosjes e instalimit dhe mirëmbajtjes gjatë periudhës së garancisë, si dhe me qëllim verifikimin e origjinës së mallrave dhe të dhënave të tjera të deklaruara mbi prodhuesin.

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë katalogë/broshurë ose fragmente (faqe) të katalogut/eve të prodhuesit sipas pikes 2.3.3 duke markuar në mënyrë të qartë dhe të dallueshme produktet që oferton, me specifikimet përkatëse të markuara, në mënyrë që të verifikohet përputhshmëria me specifikimet teknike të percaktuara në dokumentat e tenderit.

Shënim: Fragmentet e katalogut/ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë që janë pjesë katalogu, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i përkasin.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 6/b, të nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Ky kriter është vendosur për të garantuar Autoritetin Kontraktor se artikujt e ofruar do të jenë prodhim i të njëjtës kompani me atë të deklaruar në ofertë dhe që përmbushin kërkesat e specifikimeve teknike.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Argumentim: Në bazë të nenit të 36, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 15, pika 3/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Specifikimet teknike janë hartuar nga specialisti fushes, anetar i njesise se prokurimit. Specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara si dhe janë në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

NJESIA E PROKURIMIT